

ANALIZË E QEVERISJES SË HAPUR TË ZYRËS SË KRYEMINISTRIT TË KOSOVËS

PROPOZIME PËR PËRMIRËSIMIN E GJENDJES AKTUALE

ANALIZË E QEVERISJES SË HAPUR TË ZYRËS SË KRYEMINISTRIT TË KOSOVËS

RRETH PUBLIKIMIT

Ky dokument është zhvilluar në kuadër të projektit ‘Promovimi i Qeverisjes së Mirë 3.0’, mbështetur nga National Endowment for Democracy (NED) dhe zbatuar nga Open Data Kosova (ODK).

AUTORE:

Dafina Olluri dhe Delvina Haxhijaha

VERSIONET GJUHËSORE:

ALB, ENG, SRB

Përfunduar në janar 2023 © ODK

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të NED-it. Riprodhimi dhe përkthimi për qëllime jo komerciale është i autorizuar, me kusht që burimi të dihet dhe botuesi të njoftohet paraprakisht dhe t'i dërgohet një kopje.

HYRJJE

Transparenca legislative në një demokraci mund ta përmirësojë performancën parlamentare dhe ta rrisë angazhimin e qytetarëve për një shoqëri më të hapur dhe më transparente. Pasi që lëvizja e qeverisë së hapur ka qenë shqetësim i madh global viteve të fundit, mënyra se si qeveria e hapur ndikon në zhvillimin e qëndrueshëm të shteteve është bërë çështje e rëndësishme. Sipas analizës së realizuar nga ODK-ja ndër vite, e cila ka përcjellë dhe vlerësuar qeverisjen e hapur dhe transparencën e aktiviteteve të Zyrës së Kryeministrit (ZKM) në Kosovë, ndërveprimi dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me qytetarët shërben si forca shtytëse pas përmirësimit të performancës. Efektiviteti i qeverisë dhe veprimeve të saj në përgjithësi përmirësohet përmes pjesëmarrjes së publikut. Departamentet dhe agjencitë ekzekutive duhet t'iu japin qytetarëve të Kosovës më shumë mundësi për të ndikuar në politika dhe për t'i ndihmuar qeverisë së tyre me njohuritë dhe informatat e tyre të kombinuara.

Parimet udhëzuese të qeverisë së hapur, transparencës, angazhimit dhe llogaridhënies kërkojnë inovacion nga ana e institucioneve qeveritare në mënyrën si lidhen me qytetarët dhe si i udhëheqin administratat e tyre. Autoritetet duhet ta bëjnë më të thjeshtë procesin e marrjes së informatave për qytetarët në mënyrë që të jenë transparente, veçanërisht përmes përdorimit të të dhënave të hapura dhe menaxhimit të të dhënave. Duhet të kombinohet me përfshirje të shtuar të shoqërisë civile në procesin e vendimmarrjes publike. Garancia që qeveritë drejtohen në mënyrë efektive dhe pa korrupsion sistemik, disponueshmëria e informacionit lidhur me politikën dhe aktet qeveritare dhe kuptimi i qartë i përgjegjësive organizative janë elementet thelbësore të qeverisjes transparente. Ekzistenca e nismave ndërkombëtare në Kosovë, siç është Partneriteti për Qeveri të Hapura (PQH), pritët se do të ndihmojë në rritjen e transparencës së institucioneve të pushtetit ekzekutiv në vend – duke dëshmuar gatishmërinë e Qeverisë për zbatimin dhe promovimin e standardeve të transparencës dhe llogaridhënies.

Qëllimi i këtij studimi është t'i paraqesë rezultatet e Indeksit Rajonal të Qeverisjes së Hapur të realizuar për zyrën e Kryeministrit në Kosovë për vitin 2021, duke e matur nivelin e qeverisjes së hapur për institucionin e lartpërmendur. Për shumë vite, ODK-ja e ka përmirësuar vazhdimisht metodologjinë dhe treguesit e saj, duke iu përshtatur kërkesave të vitit përkatës. Ky dokument i politikës po ashtu e ofron një element krahasimtar ku ODK-ja e ka hartuar një analizë, duke përfshirë progresin e treguar gjatë viteve të fundit për ZKM-në. Ky dokument po ashtu synon t'i përforcojë parimet e qeverisjes së mirë dhe t'iu ndihmojë institucioneve t'i zbatojë ato në mënyrë më efektive në punën e tyre. Studimi mund të jetë i dobishëm për përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare, si dhe kolegët nga sektori i OSHC-ve që merren me këto çështje.

ODK-ja i ka respektuar parimet e transparencës në hulumtim dhe ia ka paraqitur të gjithë hollësitë dhe rezultatet e tij institucionit të vlerësuar. ODK-ja mbetet e hapur për çdo sugjerim, kritikë konstruktive dhe diskutim lidhur me këtë dokument të politikës.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Katër parimet e mëposhtme udhëzuese kanë shërbyer si themel për këtë analizë, e cila ka monitoruar sa janë marrë të dhëna nga Indeksi Rajonal i Qeverisjes së Hapur lidhur me ZKM-në, mjet ky që vlerëson sa janë të qasshme institucionet qeveritare për publikun dhe shoqërinë në shtetet e Ballkanit Perëndimor. Për ZKM-në, janë vlerësuar këto parime: 1) transparencja, 2) qasja, 3) integriteti dhe 4) ndërgjegjësimi. Këto parime janë vlerësuar në bazë të kriterëve në vijim: lehtësia e qasjes në informata në uebfaqen zyrtare të Institucionit; cilësia e kornizës legislative për temat përkatëse; burimet publike shtesë të informacionit; dhe pyetësorët e dorëzuar nga institucioni. Pas mbledhjes së të dhënave është përdorur një model i verifikimit të të dhënave, që ka rezultuar me gabimin standard prej +/- 3%. Vlerësimi është bërë nga qershori 2021 deri në fund të tetorit 2021. Bazuar në gjetjet e hulumtimit, është përpiluar një listë me rekomandime për institucionet.

Qasja e publikut në të dhënat organizative, buxhetet dhe proceset e prokurimit publik është e mandatuar me parimin e **Transparencës**. **Qasja** ka të bëjë me hartimin dhe zbatimin e politikave për qasje të pakufizuar në informacion, rritjen e qasjes në informacion përmes diskutimeve publike dhe promovimin e angazhimit të qytetarëve. **Integriteti** përfshin elementet si lobimi, respektimi i kodit të etikës dhe luftimi i korrupsionit. Parimi i fundit, **Ndërgjegjësimi**, trajton monitorimin dhe vlerësimin e politikave të zbatuara nga institucionet.

Të gjitha katër parimet e lartpërmendura, si pjesë e Indeksit Rajonal të Qeverisjes së Hapur, ndihmojnë në përcaktimin, prezantimin dhe vlerësimin e punës dhe vullnetit të mirë politik drejt transparencës.

QEVERISJA E HAPUR E ZYRËS SË KRYEMINISTRIT NË VITIN 2019

Zyra e Kryeministrit shënoi një rezultat të përgjithshëm prej 63% në vitin 2019. Ky rezultat tregon progresin që është arritur në krahasim me rezultatet e viteve të kaluara, megjithatë ende ka hapësirë për përmirësim në krahasim me shtetet e tjera të rajonit, sidomos nëse flasim për aspektin mbarështetëror. Kur e krahasojmë rezultatin prej 63% në vitin 2019 me atë prej 53% në vitin 2018, vërehet progres i madh brenda vitit mes dy rezultateve.

QEVERISJA E HAPUR E ZYRËS SË KRYEMINISTRIT NË VITIN 2020

Zyra e Kryeministrit mori një rezultat të përgjithshëm prej 62% për vitin 2020. Institucioni në fjalë duhet të jetë vazhdimisht edhe më i hapur dhe transparent me publikun dhe palët e treta – duke dhënë kështu shembull për institucionet e tjera, siç janë ministritë e linjës. Zyra e Kryeministrit ka ende shumë hapësirë për përmirësim, veçanërisht në parimin e transparencës, pasi që ka shënuar rezultat prej 41% për vitin 2020, krahasuar me 51% për vitin 2019.

QEVERISJA E HAPUR E ZYRËS SË KRYEMINISTRIT NË VITIN 2021

Rezultati i përgjithshëm për Zyrën e Kryeministrit për vitin 2021 ishte 69%. ZKM-ja duhet të jetë vazhdimisht edhe më e hapur dhe transparente me publikun e gjerë dhe palët e tjera, duke krijuar kështu një ndjenjë të qartë të llogaridhënies Institucionale, e cila është komponent thelbësor i qeverisjes së hapur.

Në kapitullin vijues, është dhënë një shpjegim i hollësishëm i parimeve dhe rezultateve kryesore të Zyrës së Kryeministrit në katër parimet e qeverisjes së hapur, që përfshin: transparencën, qasjen, integritetin dhe ndërgjegjësimin.

TRANSPARENCA

Parimi i transparencës në vitin 2021 arriti një rezultat prej 57%, që shënoi rritje krahasuar me vitet e mëparshme. Parimi i transparencës parashikon që informatat organizative, buxheti dhe procedurat e prokurimeve publike janë në dispozicion të publikut dhe publikohen në faqen zyrtare të internetit.

Sa i përket transparencës organizative, uebfaqja zakonisht ka të publikuara mjaft lajme nga mbledhjet e qeverisë, dokumente zyrtare, raporte, strategji, plane vjetore të punës dhe vendimet e fundit. Për më tepër, informatat e paraqitura në uebfaqen janë të disponueshme në dy gjuhët zyrtare të vendit. Megjithatë, duhet të theksohet që përkundër përmirësimeve në fushat e cekura më lart, ende ka disa mangësi sa i përket transparencës institucionale. Uebfaqja zyrtare nuk ofron informata lidhur me përfaqësuesin për qasje në dokumente publike. Poashtu, nuk janë publikuar informata lidhur me të dhënat rreth transparencës buxhetore, kontratave, raporteve buxhetore. Nuk ka informata të disponueshme rreth fushëveprimit të shpenzimeve publike, të shërbimeve dhe të menaxhimit.

Zyra e Kryeministrit vazhdon të mos ofrojë informata për praktikën e prokurimit publik, siç janë kërkesat e hapura për prokurim, vendimet dhe kontratat e prokurimit dhe informacione të tjera, edhe gjatë gjithë vlerësimit të këtij viti. Gjithashtu, Zyra e Kryeministrit nuk ofron listën e bizneseve që janë shpallur fajtorë për ryshfet në procedurat e prokurimit dhe për këtë arsye iu ndalohet ofertimi për kontratat e ardhshme. Platforma e kompjuterizuar e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, e-prokurimi, megjithatë ofron informata të tilla. Në këtë drejtim, Zyra e Kryeministrit duhet të vërë në dispozicion në uebfaqen e saj një lidhje të jashtme që i tregon përdoruesit për të dhënat e nevojshme ose platformën e-prokurimi.

QASJA

Parimi i Qasjes trajton nivelin e qytetarëve, OSHC-ve dhe akterëve të interesuar për të marrë pjesë në punën e Qeverisë, përfshirë, mes tjerash, Aktin për lirinë e informacionit dhe rregullore të tjera. Për këtë vit vlerësimi, ZKM-ja shënoi 69% në këtë parim.

Edhe pse vlerësimet tregojnë një infrastrukturë të mirë për lirinë e informacionit, e cila më së shumti sigurohet përmes Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, ende ka mungesë zbatimi në praktikë. Sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, çdo institucion publik duhet ta caktojë një person për të shqyrtuar në mënyrë rutinore kërkesat e pranuar dhe për të krijuar një adresë elektronike zyrtare që përdoret vetëm për komunikim me publikun. Ky ligj ka zbatim praktik sepse ekziston një individ i caktuar që iu përgjigjet kërkesave për liri të informacionit brenda një afati minimal të pranueshëm kohor. Megjithatë, mbikëqyrja e kërkesave që janë refuzuar ose pa përgjigje është ende e pakët sa i përket raportimit vjetor për qasje në dokumente publike. Lidhur me kërkesat për qasje në të dhënat publike, e drejta për qasje në të dhënat publike shpesh është zbatuar vetëm si rezultat i përfshirjes së Agjencisë së Informacionit dhe Privatësisë (IPA).

Rekomandohet funksionalizimi i një sistemi që do t'i regjistronte kërkesat e pranuar dhe statusin e tyre edhe gjatë këtij viti të vlerësimit. Një proces i tillë do t'i ndihmonte Zyrës së Kryeministrit të bëhej më transparente dhe e hapur për publikun, duke përmirësuar rezultatin e saj në komponentin e qasjes.

Një problem tjetër është se e drejta e qasjes në informacion vazhdon të mos zbatohet për ndërmarrjet shtetërore, shoqëritë publike apo subjektet e tjera që janë në pronësi apo kontroll të qeverisë. Institucionet njëjtë si Zyra e Kryeministrit nuk arrijnë të sigurojnë një listë apo regjistër publik të dokumenteve të disponueshme dhe t'i bëjnë ato publike, edhe pse kjo është e paraparë me ligj. Progresi në këto fusha, që është relativisht i lehtë për t'u zbatuar, do të ndihmonte dukshëm në rritjen e rezultatit të Kosovës, por nuk konsiderohet të jetë në agjendën e këtyre institucioneve.

Sa iu përket konsultimeve publik, Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë ka krijuar platformën e Konsultimeve Publike ku të gjitha dokumentet e nevojshme për konsultim publikohen online nga ministritë për çështjet përkatëse. Po ashtu, publikohen edhe raportet mbi konsultimet. Struktura e konsultimit publik është e rregulluar me Rregulloren (QRK) Nr. 05/2016 për Standardet minimale për procesin e konsultimit publik, neni 21¹. Edhe pse ZKM-ja ka obligim t'iu përgjigjet komenteve dhe sugjerimeve të paraqitura përmes konsultimeve publike sipas rregullores së lartpërmendur, neni 15, Mbledhja e komenteve dhe adresimi i tyre², megjithatë, në anketën dërguar ZKM-së, kur u pyet për disponueshmërinë ose ekzistencën e një procedure që qytetarët dhe palët e interesuara t'i kundërshtojnë vendimet e marra për çfarëdo arsye, nuk është dhënë asnjë përgjigje.

1

Faqet zyrtare të Zyrës së Kryeministrit në Facebook dhe Twitter, të cilat bartin lajme rreth Zyrës në fjalë në uebfaqet e tyre, janë marrë parasysh gjatë vlerësimit të qasjes së ZKM-së në mediat sociale. Llogaria e kryeministrit të vendit është e lidhur me llogaritë në mediat sociale siç është Twitter dhe Instagram, të cilat përditësohen shpesh me informatat më të fundit. Përveç kësaj, Kryeministri i vendit është aktiv me përditësimet në profilin e tij në Facebook me lajmet e fundit, duke i mbajtur kështu akterët e interesuar dhe audiencën e përgjithshme të informuar rreth zhvillimeve më të fundit. Kjo e promovon qasjen ndërkohë që po ashtu e njofton publikun rreth aktiviteteve të Zyrës.

INTEGRITETI

Në parimin e Integritetit, ZKM-ja vazhdon të arrijë progres vit pas viti. Për këtë vlerësim, ZKM-ja shënoi 91%. Kjo rritje i atribuohet më së shumti Agjencisë për Administrimin e Shërbyesve Civilë. Të gjithë deputetët duhet ta deklarojnë pasurinë e tyre përmes kartelave të aseteve në përputhje me këtë kod. Duke pasur parasysh që kodi i mirësjelljes,³ konflikti i interesit dhe deklarimi i pasurisë janë të gjitha të rregulluara, ky institucion merr një notë të lartë në vlerësimin e integritetit të tij. Qeveria duhet të sigurojë që ka masa proaktive të raportimit mbi etikën, duke përfshirë kështu protokollet për sjelljet e përshtatshme dhe të gabuara për shumë grupe të ndryshme, siç janë udhëheqësit e zgjedhur (Kryeministri dhe Ministrat e Kabinetit), përfaqësuesit e zgjedhur (deputetët), stafi politik dhe shërbyesit publikë.

Për më tepër, Kosovës aktualisht i mungon zbatimi i ligjeve që i rregullojnë lobuesit dhe veprimet e tyre, të cilat do të shërbenin për përmirësimin e mbrojtjes së interesit publik. Duke pasur parasysh se Kosova ka miratuar Ligjin për Sinjalizuesit, rekomandohet që Qeveria të fillojë të ofrojë trajnime për zyrtarët e saj për temat si konflikti i interesit, përpjekjet për luftimin e korrupsionit, apo sinjalizimi, si dhe si të përgjigjen në rastet e parregullsive.

1 <http://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Docs/Doc-58b8199b1839d.pdf>

2 <http://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Docs/Doc-58b8199b1839d.pdf>

3 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10764>

NDËRGJEGJËSIMI

Në komponentin e fundit të vlerësimit, Zyra e Kryeministrit të Kosovës shënoi rezultat prej 86%. Komponenti i ndërgjegjësimit adreson mekanizmat e brendshëm që përdoren për monitorimin dhe vlerësimin e politikave të zbatuara nga Zyra e Kryeministrit.

Një pasqyrë kontekstuale tregon se Kosova ka qenë e ekspozuar ndaj shumë projekteve dhe politikave të udhëhequra nga donatorët. Megjithatë, nuk ekziston një mekanizëm për monitorimin e performancës së këtyre projekteve dhe politikave dhe ndikimin e programeve dhe planeve të reformës. Progresi ose regresi që nuk dokumentohet përbën një sfidë të madhe për transparencën, si dhe rrezik për joefikasitet në të ardhmen.

Gjatë analizimit të nënfushës së planifikimit strategjik në kuadër të komponentit të ndërgjegjësimit, vlen të theksohet se në kuadër të Zyrës së Kryeministrit funksionon Zyra për Planifikim Strategjik (ZPS). Kjo zyrë e këshillon Kryeministrin dhe Qeverinë për prioritetet e politikave strategjike të Qeverisë, koordinon procesin e planifikimit strategjik dhe shqyrton dokumentet strategjike për të siguruar përputhshmëri mes tyre dhe prioriteteve strategjike të Qeverisë. Gjithashtu, Zyra e Kryeministrit përdor si tregues të performancës gjatë hartimit të raporteve vjetore të punës Objektivat Operative në planin strategjik operativ (Konsultimi i politikave dhe legjislacionit). Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit ka punuar për krijimin e standardeve për konsultimet publike në bashkëpunim me të gjitha ministrinë e linjës përmes koordinatoreve për konsultime në ministrinë e linjës të përfshira në procesin e hartimit të legjislacionit dhe politikave.

Gjithashtu, vlen të theksohet se raportimi i ministrive vazhdon të jetë në përputhje me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Kosovës, e cila e përcakton mënyrën dhe llojin e informacionit që kërkohet në raportet e ministrisë – të cilat i dërgohen Zyrës së Kryeministrit për miratim.

ANGAZHIMI I QYTETARËVE NË PUNËN E ZKM-SË NË KOSOVË

ODK-ja ka vazhduar bashkëpunimin e saj me UBO Consulting duke hulumtuar përkushtimin dhe mendimet e qytetarëve për punën e Qeverisë së Kosovës. Gjithsej 1306 qytetarë të Republikës së Kosovës u intervistuan përmes metodës së mostrës gjithëpërfshirëse, të ndarë sipas moshës, gjinisë, përkatësisë etnike, vendbanimit dhe të ardhurave familjare. Anketa vlerësoi angazhimin e qytetarëve me punën e ZKM-së, duke analizuar nëse qytetarët besojnë se interesat e tyre merren parasysh, nëse besojnë se mund të kontribuojnë në zhvillimet e institucionit në fjalë, etj.

Bazuar në gjetjet e anketës së realizuar, përqindja e pjesëmarrësve të cilët raportuan se e ndjekin pak punën e Zyrës së Kryeministrit është 29.8% në mesin e grave dhe 32.4% në mesin e burrave. Në anën tjetër, puna e Zyrës së Kryeministrit ndiqet shumë nga 4.6% e grave dhe 10.8% e burrave.⁴

Pyetja e radhës që u adresua ishte se sa mendojnë pjesëmarrësit që vendimet e Qeverisë i reflektojnë pikëpamjet e tyre.⁵ Bazuar në gjetjet e anketës, 29.9% e grave dhe 28.7% e burrave të anketuar mendojnë se vendimet e qeverisë i reflektojnë pikëpamjet e tyre, ndërsa 46.1% e grave dhe 53.1% e burrave mendojnë të kundërtën. Për pyetjet pasuese, më shumë se gjysma e pjesëmarrësve nuk mendojnë se mund të kontribuojnë në nismat e Qeverisë së Kosovës. Në anën tjetër, 31.7% e burrave dhe 28.4% e grave të anketuara mendojnë të kundërtën. Është e rëndësishme të ceket që në pyetjen e fundit që iu është adresuar pjesëmarrësve, vetëm 36.3% e burrave dhe 27.2% e grave mendojnë se mund të kontribuojnë në punën e Institucionit në fjalë. Në anën tjetër, 17.8% e burrave dhe 12.4% e grave të anketuara në lidhje me këtë çështje nuk kanë mendim të caktuar.

Gjetjet e anketës theksojnë se sa është e rëndësishme të merren parasysh mendimet e qytetarëve lidhur me punën e ZKM-së. Si pasojë, përpjekjet duhet të drejtohen drejt krijimit të kanaleve të komunikimit që iu mundësojnë individëve të ofrojnë komente për punën e Institucionit, të shihet angazhimi qytetar si i domosdoshëm për efektivitetin e tij dhe të ofrohen mundësi për bashkëpunim mes qytetarëve dhe akterëve të tjerë përkatës.

⁴ <https://www.facebook.com/opendatakosovo/posts/pfbid02SJs3LoNPs4bkev7VmPN19kb9fy4GmmGoxaPuEQYvJwHD63HBbR2MeJqN74YxFW3gl>
⁵ <https://www.facebook.com/opendatakosovo/posts/pfbid02XPqgJCufPa6nPuiJcEWZvz5P8BcMhSX2W2vW3NKNHmdq8FKNrsDqavwGdW6u9ennl>

REKOMANDIMET

HAPAT E VEPRIMIT

Qeverisja e hapur është term ombrellë për një varg të gjerë praktikash që i çojnë përpara këto parime, duke përfshirë nismat për të dhëna të hapura, ligjet e qasjes në informacion, të drejtat politike, konsultimet publike dhe proceset e angazhimit, ndër shumë të tjera. Sipas vlerësimit të realizuar, rekomandohet që Zyra e Kryeministrit t'i ndër marrë veprimet e mëposhtme për ta mbajtur këtë performancën të mirë në punën e saj:

- *Themelimi i një mekanizmi përmes të cilit qytetarët mund t'i sfidojnë vendimet që merren përmes një procesi të përshtatshëm;*
- *Zhvillimi i Kodit të Etikës dhe themelimi i mekanizmave të qartë për zbatimin e tij;*
- *Zhvillimi i bazës ligjore për një proces transparent të buxhetimit duke përfshirë pjesëmarrjen publike në përgatitjet e buxhetit të shtetit;*
- *Krijimi dhe publikimi i Buxhetit të Qytetarëve;*
- *Publikimi i programit vjetor të punës, informata rreth personelit (duke përfshirë emrat dhe pozitat), pagat, kontaktet, fushëveprimin e punës së institucionit, organogramin, rezymetë es-tafit dhe raportet e punës si dhe listën e regjistrave të dokumenteve që i ka në posedim në uebfaqe;*
- *Rregullimi i rregullave të lobimit me ligj;*
- *Krijimi i një formulari të ankesave në uebfaqen zyrtare të Zyrës së Kryeministrit duke ofruar informata mbi kronologjinë, shërbyesit përkatës civilë dhe institucionet që merren drejtpërdrejt me ankesat/kërkesat e caktuara;*
- *Të sigurohet që planet, thirrjet, vendimet, kontratat dhe shtojcat lidhur me prokurimin publik publikohen në uebfaqen e saj;*
- *Inkurajimi dhe mbështetja e anëtarësimit në Partneritetin për Qeveri të Hapura;*
- *Publikimi i transmetimeve me audio dhe/ose video të mbledhjeve të Qeverisë në uebfaqen zyrtare;*
- *Publikimi i planit të integritetit ose politikës së brendshme kundër korrupsionit, duke përfshirë masat për parandalimin e formave të ndryshme të korrupsionit dhe sjelljes joetike brenda institucionit;*
- *Publikimi i pagave të zyrtarëve publikë në uebfaqe;*
- *Sigurimi i një liste të kompanive të dënuara për ryshfet të cilave iu ndalohe pjesëmarrja në ofertat e ardhshme të prokurimit.*